



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 30.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 30.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Froni 1" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 30.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit cituar si në vijim:

- *“Në dosjen e tenderit keni kërkuar: Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqes, pikërisht: • Specialist i mjedisit 1, i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi, duhet te kete te pakten nje diplomë bachelor me min pesë vjet përvojë ne nje natyrë të ngjashme, - njëherit mund të sqarohet kjo kërkesë: mbase nuk ka neveojë të eliminohet - Pyetja është: pyetja është pikërisht për specialist i mjedisit për ing. ndërtimi. Cka nënkupton fjala specialist i mjedisiti a është e vlefshme dhe e pranueshme nëse një ing. ndërtimi është i licencuar nga MMPH për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM). Po ashtu, a është e pranuar nga ana juaj ing ndërtimi i trajnuar për specialist të mjedisit nga një qendër trajnimi me certifikatë valide”.*
- *“OE-ik duhet te posedoje mjete, stabilimente dhe paisje teknik qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizmi i obligueshem sipas aneksit 8 te DT. - tek lista a paisjeve, 1. Kamion kiper me peshë bartëse 20-30 Ton - 4. Në këtë pikë, kufizimi mes 20 - 30 ton, është i panevojshëm, meqë këto si dimensione të kamionit dhe si peshë e përbashkët dhe kapaciteti vëllimor për këtë paisje është i njëjtë (15 m3), pra, kamionët kiper me kapacitet vëllimor 15 m3 - kanë peshë bartëse 18500 kg deri 30000 kg, ndërsa, vetëm një kompani ka mundësi të ketë këto paisje dhe përbën rrezikim të monopolit ky kriter dhe janë kamionë që manipulohen me vështirësi. Prandaj ky kufizim është diskriminues për kompanitë ose favorizues për një kompani të vetme”.*
- *“Certifikatat ISO - Kërkojmë korrigjimin e dosjes, largimi i standardit ISO 3834-2/2021, për arsye se është i panevojshëm lidhur me implementimin e këtij projekti dhe si i tillë është diskriminues respektivisht favorizues nda një kompanie të caktuar”.*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 29.08.2023 njësia kërkuese ka dërguar përgjigjet si në vijim:

“Lidhur me emailin e percjell nga ana e juaj e qe ka te bej me kerkesen per rishqyrtim te aktivitetit te prokurimit Ndertimi i therrtores publike po ju percjellim komentet si me poshte:

1. *Po, është e vlefshme dhe e pranueshme nëse një ing. Ndërtimi është i licencuar nga MMPH për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM);*
2. *Nese kamionet e jauj, kamionët kipper jane me kapacitet vëllimor 15m3 - kanë peshë bartëse 18500 kg deri 30000 kg. ,pra eshte brenda kerkeses nga 20 deri 30 ton;*
3. *ISO 3834-2 përcakton kërkesat gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike si në punishte ashtu edhe në vendet e instalimit në terren. Sistemet e menaxhimit të cilësisë në saldim janë të destinuara për të gjitha organizatat që merren me saldim gjatë prodhimit të produkteve. Kjo qertifikate eshte e domosdoshme per objektet te ketij karakteri qe kerkojne angazhim te stafit profesional per ekzekutim te ketyre puneve. Si do qe te jete edhe njehere e konfirmojme se nese ju si zyre e prkurimit e konsideroni se ndonje specifike apo kriter eshte diskriminues per ndonje operator ekonomik duke u bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik, ateher ju lutem veproni sipas ligjit perkates”.*

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përgjigjeve të njësisë kërkuese sipas të cilave të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të bazuara. Rrjedhimisht kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimet ankimore duhet të riformulohen duke marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit ashtu që të evitohet çdo mundësi për të vepruar në kundërshtim me parimet themelore të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.09.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.